

VENDIM
Nr. 378, datë 8.5.2020

**PËRNJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE
TË AKOMODIMIT TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në programin “Zhvillimi i turizmit”, në artikullin 602 (shpenzime operative), për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, i shtohet fondi prej 95 200 000 (nëntëdhjetë e pesë milionë e dyqind mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve në strukturat akomoduese të miratuara nga Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile, për akomodimin e përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

2. Efekti financiar, prej 95 200 000 (nëntëdhjetë e pesë milionë e dyqind mijë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2020.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama